

Të gjeturat kryesore sipas renditjes së agjencive që janë trajtuar në këtë punim janë:

### **Autoriteti i Aviacionit Civil:**

AAC ka shumicën e funksioneve që mund të klasifikohen si ekzekutive/administrative, ka target primar për raportim Ministrinë e Infrastrukturë dhe Qeverinë derisa bordi dhe drejtori i përgjithshëm zgjedhen dhe shkarkohen nga Ministria dhe Qeveria. Në këtë kuadër, AAC duhet të jetë agjenci në kuadër të Qeverisë;

### **Autoritetit Kosovar i Konkurrencës:**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka funksione rregullatore dhe rol të madh në mbrojtjen e konkurrencës mirëpo pavarësia e tij funksionale dhe organizative nuk është e plotë;

### **Agjencia Kosovare e Privatizimit:**

Funksionet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk përkojnë me funksionimin dhe raportimin në Kuvend të Kosovës. MSA dhe PKZMSA nuk kanë ndonjë referencë sa i përket mënyrës së funksionimit dhe raportimit të agjencisë.

### **Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare:**

Funksionet e Autoritetit janë tipike rregullatore dhe duhet të sigurohet pavarësia e tij nga ekzekutivi. Në anën tjetër, fakti që Ministri i rekomandon anëtarët e bordit dhe Qeveria i propozon për emërim në Kuvend, pa pasur ndonjë konkurs publik paraprak, krijon mundësi të madhe për ndikim në zgjedhjen e anëtarëve të caktuar për anëtar të bordit dhe më pas vënë në pikëpyetje pavarësinë e institucionit nga ekzekutivi etj.